

# Taksa dhe seleksionimi i mbeturinave



Çdo Komunë organizon mbledhjen dhe trajtimin e mbeturinave. Financimi i këtij shërbimi përfshin një **taksë të<sup>1</sup>** qytetit (koshat e mbeturinave) që varen nga një qytet në një qytet tjetër. Për shembull, në Liège shuma që duhet të paguhet është 100€/ në vit për një person vetëm dhe 155€ për një familje. Kujdes, kjo taksë duhet të paguhet me 1 janar të vitit në përgatitje : nëse ndërroj adresë, unë duhet ti paguaj Komunës për banesën e mëparshme.

Çdo familje duhet të seleksionojë mbeturinat sipas udhëzimeve të dhëna nga Komuna. Seleksionimi i mbeturinave është i detyrueshëm. Nëse nuk e respektoni mund të keni gjoba. Të shumtën e kohës seleksionimi organizohet në këtë mënyrë: Thasët me ngjyre të bardhë janë për mbeturinat shtëpiake që nuk mund të reciklohen. Thasët mirren çdo javë sipas planingut të komunikuar nga Komuna.

Thasët blu **PMC** janë për ( plastikët , metalet, kartonat e pijeve): mund të hedhim amballazhimet dhe shishe plastike, kutijat e konservave, tasat e pijeve , deodorantët kozmetikë, dhe ushqimorë , kartonat e pijeve (të quajtura brick-packs)...



Nuk duhet të hidhni asnjë gjë tjetër , përndryshe thasët do t'ju refuzohen . Thasët mblidhen në mënyrë të rregullt sipas planingut të komunikuar nga Komuna. Kujdes, poçat, amballazhimet me plasmas, mbështjellset ushqimore, letrat e aluminit dhe shkumat e detit nuk janë PMC !



Në rast dyshimi, ju shikoni vizatimet dhe shpjegimet të stampuara në thasët PMC.



<sup>1</sup> Për ata që nuk kanë shumë të ardhura , një kërkesë e përjashtimit ( që përjashtoheni nga pagesa e taksës) mund të bëhet

# Taksa dhe seleksionimi i mbeturinave



**Letrat dhe kartonat** duhet të ruhen veças. Ato duhet të jenë të lidhura mirë me spango ose ti vëni në një karton. Letrat janë gjithashtu të mbledhura çdo javë

sipas planingut të komunikura nga Komuna.



**Objektet që pengojnë** nuk mund të hidhen në koshin e mbeturinave. Një mbledhje e veçantë është planifikuar një herë në muaj ose me kërkesën në numrin e interesuar nga Komuna : objektet e mëdhaja, hekurinat, mobiljet, dyshekët,, nuk mund të lihen në vendet publike vetëm ditën kur mblidhen. Kujdes aparatat elektro shtëpiake, TV, radio, videoja, mbeturinat ndërtimore nuk janë të pranuar : ato duhet të lihen në një park për këtë gjë



**Xhamat** lihen në koshat e xhamave që i gjeni në vendet publike : kavanozat, shishet, shishet e vogla prej xhami hidhen bosh dhe të pastërta, duke ndarë xhamat e bardhë nga xhamat me ngjyrë.



Në disa komuna, kur paguaj taksën time të urbanizmit, unë marr bono për ti shndëruar me thasët e mbeturinave. Kur nuk kam thasë në stok, mundem ti blej në supermarketë dhe tjera vende shitjeje. Në komuna të tjera, egziston një sistem koshash me mikro procesorësh. Taksa ime e urbanizmit më autorizon një numër të kufizuar të mbledhjeve falas: jashtë kësaj kuote, unë paguaj tepricën e peshës. Formula të tjera egzistojnë për të kufizuar mbeturinat shtëpiake. Objektivi është me të vërtetë që të nxisim qytetarët të bëjnë sa më pak mbeturina.